



Republika e Kosovës Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

01.Nr 06-1604/1
Dragash, 28.09.2012

Kuvendi i Komunës së Dragashit ne bazë të nenit 40 frakcion 40.2. nënë b.të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenit 53 te Statutit të Komunës së Dragashit, ne seancën e mbajtur më 28.09.2012, morri këtë:

V E N D I M
MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË DRAGASHIT
PËR VITIN 2013 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2014 DHE 20115

Neni 1.

Miratohet Buxheti i Komunës së Dragashit për vitin 2013 në shumë prej 5,765.264 euro

Neni 2.

Buxheti i Komunës së Dragashit përbëhet prej mjeteve nga mjetet e Grantit të Qeverisë të lejuara me Qarkoren Buxhetore 2013/02 dhe mjeteve vetanake të planifikuara të komunës të parapara për vitin 2013 dhe atë:

Mjetet nga nga grantet	5.345264.00 euro
Mjetet vetanake	420.000.00 euro

Totali:	5,765264.00 euro
----------------	-------------------------

Buxheti Sipas Granteve:

Granti i Përgjithshëm	2.555.540.00 euro
Granti i specifik i arsimit	2.144,892.00 euro
Granti specifik i shëndetësisë	644,832 euro

Mjetet vetanake	420,000.00 euro
-----------------	-----------------

Totali:	5,765,264.00 euro
----------------	--------------------------

Te hyrat vetanake sipas burimeve janë:

-Tatimi në pronë	145,000.00 euro
-Taksat komunale	136,000.00 euro
-Ngarkesat komunale	77,000.00 euro
-Te hyrat tjera	27,000.00 euro
- Te hyrat nga participimi në shëndetësi	35,000.00 euro

Totali:	420,000.00 euro
----------------	------------------------

Neni 3.

Shpërndarja e mjeteve te Buxheti te Komunës se Dragashit, sipas Programeve Buxhetore është:

1.Zyra e Kryetarit	123,463.00
2. Zyra e K Komunal	105,500.00
2. Administrata dhe Personeli	219,794.00
3. Buxhet Finaca	157,441.00
4.Shërbime Publike, Mbrojtje Civile dhe Emergjente	122,215.00
5. Zyra e Komuniteteve dhe Këthimit	34,500.00
6.Bujqesi ,Pyltari,Zhvillim Rural dhe Inspekc.	83,472.00
7.Plan.Urban dhe Mjedis	1,848,228.00
8.Gjeodezi dhe Kadastër	38,000.00
9. Shëndetës dhe Mirqenje sociale	755,509.00
11.Kulturë, Rini dhe Sporet	53,980.00
12.Arsimi	2,223,162.00
Totali i shpenzimeve	5,765.264.00

Neni 4.

Në programet buxhetore të prezantuara ne nenin 3. të këtij Vendimi hyn : Pagat dhe shtesat **3.280.000.00** euro ,mallërat dhe shërbimet **445.758.00** Shpenzimet komunale **111.000.00** , subvencionet dhe transferet **35.000.00** dhe shpenzimet kapitale **1.893.506.00** euro.

Neni 5.

Mjetet e tërësishme të parapara nga Neni 1. dhe 2. te këtij Vendimi sistemohen në bilancet e të hyrave dhe të shpenzimeve sipas shfrytëzuesve te përmbledhura ne formën unike ne PCF-3 të prezantuara ne mënyre te veçantë në sistemin e BDMS ,si sistem unik. Sistemimi i këtyre kategorive ne te hyra dhe shpenzime është pjesë përbërëse e këtij Vendimi të prezantuara në format tabelare për të gjithë shfrytëzuesit buxhetor.

Neni 6.

Numri i punëtorëve për vitin 2013 është limituar në 774.

- Administrata Komunale	151
- Arsimi	514
- Shëndetësia	99
- Shërbimet sociale	10

Totali: 774



Programet buxhetore duhet të sigurojnë që numri i të punësuarëve, asnjë herë, gjate vitit fiskal 2012 nuk do të tejkalon numërin e përcaktuar me programe buxhetore të limituar me Qarkoren Buxhetore 2012/02 ku është përcaktuar edhe shuma e mjeteve për paga e përcaktuar me Nenin 4. të këtij Vendimi .

Neni 7.

Pozicionet e mjeteve për paga të parapara ne formën tabelare PCF-3 është përcaktuar sipas koeficienteve të paraparë me Rregullore për te gjithë shfrytëzuesit e buxhetit, ndërsa për mallëra dhe shërbime dhe shpenzime komunale ,subvencione dhe shpenzime kapitale do te shpenzohen sipas pozicioneve të parapara ne pjesën tabelare të buxhetit, që është pjese përbërëse e këtij Vendimi .

Shpenzimi i këtyre mjeteve do të bëhet pas alokimit të mjeteve në bazë të Planit KESH për vitin 2013 dhe Rregullave dhe procedurave normale te mbështetura në Ligjin mbi Menaxhimin e Finacave Publike dhe Përgjëgjësitë ,Ligjit mbi Prokurimin Publik ,Ligjit mbi Finanacat Lokale dhe rregulloret tjera ne fuqi.

Neni 8.

Mjetet vetanake, si te hyra vetanake te Komunës, te cilat grumbullohen nga tarifat dhe ngarkesat ,tatimi në pronë, dënimet ne trafik dhe ngarkesat tjera, si dhe bashkë pagesat për kujdesin primare shëndetësor janë planifikuar në bazë të ecurive nga periudhat e viteve paraprake .Sipas këtyre ecurive, për vitin 2013, planifikohen të grumbullohen mjete në shumë prej 420.000.00 euro.

Grumbullimi, shpërndarja , bartja në BKK , alokimi dhe shfrytëzimi i i tyre do të bëhet sipas skemës së paraparë me buxhetin e komunës ,si dhe dispozitave ligjore te Ligjit mbi Buxhetin e R.Kosoves.

Neni 9.

Çdo shfrytëzues i mjeteve të buxhetit (mendohet në Programet Buxhetore të Komunës) ,si të mjeteve vetanake,po ashtu edhe për mjetet nga granti i Qeverisë ,duhet të shpenzohen në mbështetje të udhëzimeve ne fuqi.

Neni 10.

Shpenzimi i mjeteve për paga, mallëra dhe shpenzime , subvencione dhe shpenzime kapitale do te realizohet ne harmoni dhe përputhje me rregullat dhe procedurat, si dhe standardet për hargjimin e mjeteve publike.

Neni 11.

Pasqyrimi si dhe shpërndarja e mjeteve për të gjitha Programet Buxhetore të Komunës, detalisht duken në formën unike tabelare të buxhetit të përfshira në formën tabelare të çdo Programi-nenprogrami buxhetor të bashkangjitur dhe janë kryekëput bazë e këtij Vendimi.

Pjesë e këtij Vendimi është edhe Lista e Projekteve Kapitale (e cila financohet nga të hyrat vetanake dhe Garantet e Qeverisë) të përfshira si Projekte të PIP-të, për periudhën përkatëse.

Neni 12.

Buxheti për vitet 2013 - 2015 është planifikuar në bazë të Qarkores Buxhetore të Kosovës 2013/01 Qarkores buxhetore 2013/2 dhe i përfshirë në Kornizën Afatmesëme të Buxhetit për Komunën e Dragashit dhe i njëjti në vitin 2013 në total, është 5.765264.00 euro dhe për vitin 2014 parashikimi është 5,933,299.00 euro. Ndërsa parashikimi për vitin 2015 është 6,108,511.00 euro

Neni 13.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit ,implementohet nga 01. Janari .2013.

A r s y e t i m

Përgatitja e Buxhetit të Komunës së Dragashit, si kërkesë fillestare për vitin 2012-2014, ka filluar qysh në Qerrshor të vitit 2012. Periudhës përgaditore të këtij Buxheti i kanë paraprirë një numër i madhe i këshillimeve të organizuar nga MEF-i dhe OSBE-ja. Si Draft Fillestar është prezantuar në 1 dëgjim publik të organizuara nga Kryetari i Komunës dhe ZKF. Është shqyrtuar në Bordin e Drejtoreve dhe, në fund, si Draft Përfundimtar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa të KK Dragash. Në bazë të propozimeve të dala nga dëgjimet publike, propozimet nga Bordi i Drejtoreve, si dhe propozimet dhe sugjerimet e Komitetit për Politikë dhe Financa është hartuar Propozimi Final i këtij dokumenti i cili do të miratohet në Kuvendin Komunal, në seancën e mbajtur më 28 Shtator. 2012.

Krahas vitit paraprak, Buxheti i Komunës së Dragashit, për vitin 2013, është rritur për 3.9%.

Kjo rritje është si rezultat i ngritjes së Grantit të Përgjithshëm nga (2.367.178.00 euro në 2,555.540.00 ose për 7%)Të hyrat vetanake nga 400.000 në 420,000.00 euro 4% rritje..

Kryesusi i Kuvendit
z. Lulzim Rifaj



Kryetari i Komunës
z. Salim Jenuzi

Projektet e vitit 2013 Plani

Nr ren	Emri I projektit	Gramti i Qeveris	T Hyrat vetanake	Totali
1	Ndertimi ujësjesit Dragash		200,000	200,000
2	Asfaltimi I rrugve ne Dragash	45,000		45,000
3	Bashkfinacimi me donatoret	60,000		60,000
4				0
		105,000	200,000	305,000

4	Asfaltimi I rruges Plajnik Pjesmarrja	50,000		50,000
5	Kubzimi I rruges Plajnik	10,000		10,000
6	Kubzimi I rruges Xerrxe	20,000		20,000
7	Kubzimi I rruges per vorrza Shajne	25,000		25,000
8	Kubzimi I rruges Rrenc	15,000		15,000
9	Kubzimi I rruges Plave	25,000		25,000
10	Kubzimi I rruges ne F Buqe	20,000		20,000
11	Kubzimi I rruges ne f. Brezne	30,000		30,000
12	Kubzimi I rruges ne f. Brrut(Selime,kastrake,guzhde Hoxhaj Spahise	30,000		30,000
13	Kubzimi I rruges ne f. Zym	15,000		15,000
13.1	Kubzimi i Rruges Qollopek	10,000		10,000
14	Ndertimi I Shkolles Bellobrad	100,000	50,000	150,000
15	Furnizimi me kubza ne f. Bellobrad me pjesmar	12,452		12,452
16	Kubzimi I rruges ne f. Kapre	20,000		20,000
16	Kubzimi I rruges ne f. Kosave	50,000		50,000
16.1	Ujësjesi Kosave	10,000		10,000
17	Kubzimi I rruges ne f. Kuk	60,000		60,000
18	Kubzimi I rruges ne f. Buzes	6000		6000
19	Kanalizimi ne f. Kuklibeg	10,000		10,000
20	Kubzimi I rruges Kuklibeg	10,000		10,000
21	Ndertimi I Ures kryesore ne f. Bresanë	25,000		25,000
22	Kanalizimi ne fshatin Bresanë	20,000		20,000
23	Kubzimi I rruges ne f. Bresanë	70,000		70,000
24	Kubzimi I rruges ne f. Blaq	30,000		30,000
25	Ndertimi I Ures ne f. Zapluxhe	15,000		15,000
26	Kubzimi I rruges ne f. Zapluxhe	45,000		45,000
27	Asfaltimi I rruges Brrut-Zgatar	100,000		100,000
		833,452	50,000	883,452

Ren	Pershkrimi	Granti	TV	Totali
1	Ndertimi I rrugeve ne fshatitn Restelice	96194	18806	115000
2	Ndertimi I Ujësellsit ne f. Brod	75000		75000
3	Kubzimi I rrugeve ne f.Rapqe e ulet	26576		26576
4	Kubzimi I rrugeve ne f.Rapqë e lartë	35000		35000
5	Kubzimi I rruges ne drjtim te shkolles Radeshe	20000		20000
6	Kubzimi I rrugeve ne f. Leshtan	15000		15000
7	Kubzimii rrugëve ne f. Kukalan	15000		15000
8	Kubzimi I rrugës në f. Baqkë	40000		40000
9	Kubzimi I rrugëve ne f. Vraniq	20000		20000
10	Kubzimi I oborrit te shkolles ne f. Kerstec	15000		15000
11	Ndertimi ujësellsit ne f.Kerstec I ulet	15000		15000
12	Asfaltimi rrugës Orqushë	100000		100000
13	Kubzimi I rrugëve ne f. Globoqicë	40000		40000
14	Ndertimi I kanalizimit te f. Zlipotok	50000		50000
15	Kubzimi I rrugëve te f. Krushevë	40000		40000
		602770	18806	621576

Nr	Pershkrimi	Granti	TV	Totali
	Projektet e perbashkta	75000	230000	305000
	Projektet e shumices	833452	50000	883452
	Projektet e Pakices	602770	18806	621576
		1511222	298806	1810028

NR	Pershkrimi I projektit	Granti	TV	Totali
1	Blerja e automjetit		40000	40000
2	Mirmbajtja e QMF	9978	33500	43478
				83478